

VENDIM
Nr. 15, datë 12.1.2018

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMET ELEKTRONIKE TË AGJENCISË
KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në vijim të shkronjës “ë”, të pikës 5, të kreut II, të vendimit nr. 673, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shërbimet elektronike në favor të organeve dhe institucioneve të administratës publike dhe subjekteve private ofrohen nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit kundrejt aplikimit të tarifave përkatëse.

2. Tarifat, që aplikohen për shërbimet elektronike ndaj organeve dhe institucioneve të administratës publike dhe subjekteve private, janë:

a) Tarifa e kostove dhe e shërbimeve administrative për nënshkrimin elektronik, së bashku me pajisjen përkatëse;

b) Tarifa për përdorimin e modulit të administratës publike në portalin *e-Albania*, sipas shkronjës “e”, të pikës 6, të kreut II, të vendimit nr. 673, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”.

3. Tarifa e kostove dhe e shërbimeve administrative për nënshkrimin elektronik, së bashku me pajisjen përkatëse, mbulon kostot e shpenzimet për të gjitha shërbimet e kryera nga Agjencia, që nga momenti i paraqitjes së aplikimit, deri në momentin e marrjes së pajisjes me nënshkrim elektronik nga aplikanti.

Këto shërbime përfshijnë:

a) shkëmbimet e informacionit;

b) komunikimet postare;

c) kopjet e akteve shkresore dhe/ose elektronike;

ç) shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga aplikanti;

d) analizën paraprake;

dh) vlerësimin teknik të pajisjes;

e) gjenerimin e nënshkrimit elektronik;

ë) revokimin e certifikatës;

f) mirëmbajtjen e sistemit;

g) asistencën teknike, në rast problematikash, konfigurimesh apo humbjeje të pajisjes kriptografike (*e-Token*).

4. Tarifa e kostove dhe e shërbimeve administrative për nënshkrimin elektronik, së bashku me pajisjen përkatëse për organet dhe institucionet e administratës publike, do të ofrohet me tarifë 0 (zero) lekë.

Për subjektet private do të ofrohet me tarifë fikse prej:

- 6 400 (gjashtë mijë e katërqind) lekësh, përfshirë TVSH-në për pajisje me *usb Token*;

- 7 300 (shtatë mijë e treqind) lekësh, përfshirë TVSH-në për asistencë teknike 12-mujore.

Pagesa e kësaj tarife kryhet nga subjektet private në momentin e aplikimit *on-line* për kryerjen e veprimeve dhe procedurave, nëpërmjet pagesës elektronike në portalin *e-Albania*.

5. Të ardhurat e realizuara derdhen tërësisht në buxhetin e shtetit, në përputhje me vendimin nr. 432, datë 28.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijohen nga institucionet buxhetore”.

6. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama